

VENDIM
Nr. 853, datë 29.12.2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 307, DATË 16.4.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E NDËRTIMIT DHE TË
RIKONSTRUKSIONIT TË INFRASTRUKTURËS PUBLIKE NË ZONAT E REJA
TË SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, dhe 16 dhe 36; të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 3.1, shifra “... 1 831 788 178 (një miliard e tetëqind e tridhjetë e një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH ...” zëvendësohet me “... 1 931 788 178 (një miliard e nëntëqind e tridhjetë e një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH ...”;

b) Në pikën 3.1/a, shifra “... 1 177 622 177 (një miliard e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e njëzet e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ...” zëvendësohet me “... 1 277 622 177 (një miliard e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e njëzet e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH...”.

2. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama